

D E K L A R A T Ë¹

Përmes amandamentimit të Kushtetutës në vitin 2015, Republika e Kosovës ka themeluar Dhomat të specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të specializuar në kuadër të sistemit të drejtësisë të Kosovës. Organizimi, funksionimi dhe jurisdiksioni i Dhomave të specializuara dhe i Zyrës së Prokurorit të specializuar rregullohen, pos me kushtetutë edhe me ligj të veçantë, përkatësisht Ligjin Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, ligji i cili në nenin 1, paragrafi 2, ndër të tjera përcakton:

“Dhomat e specializuara brenda sistemit të drejtësisë së Kosovës dhe Zyra e Prokurorit të specializuar janë të domosdoshme për përmbushjen e obligimeve ndërkombëtare të parapara në Ligjin nr. 04/L-274, për garantimin e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës...”

Duke qenë pjesë të sistemit të drejtësisë në Republikën e Kosovës, fushëveprimi i Dhomave të specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të specializuar (më tej: Dhomat e Specializuara) funksionojnë mbi bazën e Ligjit Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, (më tej: Ligji), i cili në nenin 41 e rregullon çështjen e paraburgimit, si masë për sigurinë e të pandehurit në procedurë penale.

Paragrafi 1 i nenit 41 të Ligjit, përcakton si në vijim:

“Askush nuk privohet nga liria nga Dhomat e specializuara ose Prokurori i specializuar, apo në emër të tyre, përveç në rrethanat dhe në pajtim me procedurat e përcaktuara nga ky ligj dhe mbrojtjet e garantuara në nenin 29 të Kushtetutës”.

Kurse paragrafi 12 i nenit 41 të Ligjit, përcakton si në vijim:

“Përveç paraburgimit, Dhomat e specializuara mund t’i urdhërojnë edhe masat në vijim për ta siguruar praninë e të akuzuarit (përfshirë përmes video telekonferencës) gjatë procedurës, për ta parandaluar përsëritjen e kryerjes së veprës apo për të siguruar zhvillimin e suksesshëm të procedurës penale: a. fletëthirrjet, b. urdhër-arresti, c. dorëzani me lirim në Kosovë, nëse i akuzuari pajtohet që procedurën ta vijojë përmes video telekonferencës, d. paraburgim shtëpiak në Kosovë, nëse i akuzuari pajtohet që procedurën ta vijojë përmes

¹ Kjo deklaratë përgatitë në formë të opinionit por edhe përgjigje në pyetjen Tuaj, duke marrë në konsideratë Amendamenti nr. 24, përkatësisht nenin 162 të Kushtetutës, i cili në paragrafin 1, ndër të tjera përcakton: **“Republika e Kosovës mund të themelojë Dhoma të specializuara dhe një Zyre të Prokurorit të specializuar në kuadër të sistemit të drejtësisë të Kosovës...”**, si dhe në pajtim me Rregulloren (QRK) - nr. 06/2020 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së kryeministrit dhe ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) – nr. 07.2020, shtojca 8, si dhe Rregulloren nr.13/2013 për shërbimin ligjor qeveritar, dhe si e tillë ka për qëllim të ofrojë disa sqarime, relevante përkitazi me çështjen e kërkuar nga ana juaj, bazuar në legjislacionin përkatës në fuqi, dhe në praktikën gjyqësore, përkitazi me çështjen e caktimit e edhe vazhdimit të paraburgimit, si masë për prezencën e të pandehurit në procedurë penale.

video telekonferencës, e. premtim që të mos largohet nga vendbanimi aktual në Kosovë, nëse i akuzuari pajtohet që procedurën ta vijojë përmes video telekonferencës, f. ndalimi nga afrimi i vendeve apo personave të caktuar, g. paraqitja në stacionin e policisë apo në ndonjë vend tjetër në Kosovë, nëse i akuzuari pajtohet që procedurën ta vijojë përmes video telekonferencës dhe h. Devijimin”

Në referencë të nenit 41, Ligji jepe mundësinë shqiptimin e masës së paraburgimit, por edhe masave të tjera alternative, në pajtim me Ligjin si dhe parimet e përcaktuara me nenin 29 (E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë) të Kushtetutës.

Përkitazi me çështjen e caktimit dhe vazhdimin të paraburgimit, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, përmes rastit Br.ref.:AGJ 1455/19, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 357/2017, të 22 dhjetorit 2017, në mënyrë të zgjeruar ka bërë interpretimin e paraburgimit, në pajtim me nenin 29 të Kushtetutës, por edhe praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEND).

Përkitazi me këtë çështje, Gjykata Kushtetuese, në pikën 117 të Aktgjykimit, ndër të tjera përcakton se:

“...Megjithatë, Gjykata vlerëson se është shumë e rëndësishme që përmes këtij Aktgjykimi të Gjykatës Kushtetuese do të vendoset një standard i ri në praktiken gjyqësorë në Republikën e Kosovës dhe, **rrjedhimisht gjykatat e rregullta, në të ardhmen do të duhet të veprojnë në përputhje me parimet dhe standardet e elaboruara në këtë Aktgjykim, të cilat janë interpretuar në pajtim me praktiken gjyqësore të GJEDNJ-se.”**

Kurse sa i përket praktikës së GJENDJ, vlen ‘;i hidhet një vështrim pikave 67 dhe 68 të Aktgjykimit;

“67. GJENDJ, në praktiken e saj gjyqësore, ka përcaktuar tri kritere themelore, që duhet ekzaminuar për të vlerësuar nëse privimi i lirisë, është i ligjshëm dhe jo arbitrarisht (shih rastin e GJEDNJ-se, Merabishvili kundër Gjeorgjisë, [DHM] kërkesa nr. 72508/13, Aktgjykim i 28 nëntorit 2017, paragrafi 183).

68. Se pari, duhet të ekzistoj "dyshimi i bazuar" që një person i privuar nga liria ka kryer një veprë penale (shih rastin e GJEDNJ-se, Merabishvili kundër Gjeorgjisë, [DHM] kërkesa nr. 72508/13, Aktgjykim i 28 nëntorit 2017, paragrafi 184). Se dyti, qelimi i privimit të lirisë " është që në parim duhet të jete në funksion të zbatimit të procedurës penale" (shih, rastin e Gjykatës KI63/17, parashtrues Lutfi Dervishi, Aktvendim për Papranueshmeri i 16 nëntorit 2017, paragrafi 57, shih po ashtu rastin e GJEDNJ-se, Ostendorf kundër Gjermanisë, nr. 15598/08, Aktgjykimi i 7 marsit 2013, paragrafi 68), dhe që për më tepër, duhet të jete proporcional, në kuptimin që duhet të jete i nevojshëm "për të 15 siguruar paraqitjen e personit të afektuar para autoriteteve kompetente perkatese" (shih, rastin e Gjykatës KI63/17,

parashtrues Lutfi Dervishi, Aktvendim per Papranueshmeri i 16 nentorit 2017, paragrafi 57, shih po ashtu rastin e lartcekur te GJEDNJ-se Merabishvili kunder Gjeorgjise, paragrafi 185). Se treti, privimi i lirise apo caktimi i paraburgimit duhet tejete bere duke ndjekur proceduren e percaktuar me ligj (shih rastin e lartcekur te GJEDNJ-se Merabishvili kunder Gjeorgjise, paragrafi 186)”

Për më tepër, referuar pyetjes Tuaj përkitazi me mundësinë që Policia e Kosovës të jetë në gjendje t'i mbikëqyrë përmbushjen e kushteve eventuale, me rastin e shqiptimit të ndonjë mase alternative të përcaktuara në nenin 41 të Ligjit, ju lutëm të jeni në dijeni se një gjë e tillë është obligim ligjor i Policisë së Kosovës, i përcaktuar me legjislacionin në fuqi, dhe për më shumë së sa kaq, është edhe një praktikë madje të tillë e hasim nga viti 2004.

Po ashtu keni edhe përgjigjen e z. Samedin Mehmeti, UD. Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës.

Bashkangjitur gjeni:

- *Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, Rastin nr. KIlo/1S Parashtrues Fahri Deqani Vleresim i kushtetutshmerise se Aktgjykimit te Gjykatëse Supreme te Kosovës, Pml. nr. 357/2017, te 22 dhjetorit 2017.*
- *Përgjigjen e z. Samedin Mehmeti, UD. Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës.*

Ju faleminderit!